



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 215, datë 31.3.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NË BASHKITË LEZHË
DHE KURBIN, DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021" të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 716 338 013 (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e tetë mijë e trembëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 89 175 467 (tetëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e 42 (dyzet e dy) njësive individuale të banimit;
 - b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 627 162 546 (gjashtëqind e njëzet e shtatë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e 225 (dyqind e njëzet e pesë) njësive individuale të banimit.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit për vitin 2021, në masën 143 267 602 (njëqind e dyzet e tre milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, në bashkitë Lezhë dhe Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:
- a) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 17 835 093 (shtatëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;
 - b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 125 432 509 (njëqind e njëzet e pesë milionë e katërqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.
3. Caktimin si njësi zbatuese të bashkive Lezhë dhe Kurbin për rindërtimin e njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte që duhen ndërtuar nga e para, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Lezhë e Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 1707/1
DATË 2.4. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKIVE LEZHË DHE KURBIN
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

